

	Manual Udhëzues për Miratimin e Organizatave të Trajnimit për Ekuipazhin e Kabinës (CCTO)	
	Zotëruesi	O3
	Dokumenti	O3-3 -MU/PT-004



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Autoriteti i Aviacionit Civil i Shqipërisë



MANUAL UDHËZUES

**MANUAL UDHËZUES PËR MIRATIMIN E ORGANIZATAVE TË TRAJNIMIT PËR EKUIPAZHIN E KABINËS
(CCTO)**

TETOR 2021



Data e lëshimit: 15/10/2021	Rishikimi Nr: 00	Faqe: 1 nga 45
-----------------------------	------------------	----------------

	Manual Udhëzues për Miratimin e Organizatave të Trajnimit për Ekuipazhin e Kabinës (CCTO)	
	Zotëruesi	O3
	Dokumenti	O3-3 -MU/PT-004

Hyrje

Ky dokument është pronë e:

Autoritetit të Aviacionit Civil të Shqipërisë

Rr. Sulejman Delvina, Nr. 1
Pranë Parkut të Delegacioneve
Tiranë / Shqipëri
Po Box 205

Ndalohet çdo riprodhim ose ndryshim i këtij materiali, pa pëlqimin paraprak me shkrim.

Shpërndarja e paautorizuar e këtij manuali ose pjesëve të tij, jashtë shpërndarjes zyrtare, sipas përkufizimit të këtij dokumenti, do të cilësohet si shkelje e procedurave të AAC-së dhe do të trajtohet përkatësisht me punonjës in përgjegjës.

Ky individ mund t'i nënshtrohet procedimit ligjor nga institucionet përkatëse ligjore.

Për Autoritetin e Aviacionit Civil Shqiptar

Edlira Kraja

Drejtor Ekzekutiv



Data e lëshimit: 15/10/2021	Rishikimi Nr: 00	Faqe: 2 nga 45
-----------------------------	------------------	----------------

	Manual Udhëzues për Miratimin e Organizatave të Trajnimit për Ekuipazhin e Kabinës (CCTO)	
	Zotëruesi	O3
	Dokumenti	O3-3 -MU/PT-004

PARATHËNIE

Kërkesat e përbashkëta, gjithëpërfshirëse dhe të detajuara, të njohura si (EU) Reg. (EASA), janë të transpozuar me Rregullore Shqiptare të zbatueshme në Shqipëri dhe që mbulojnë shumë kërkesa që lidhen me parrezikshmërinë e Avionëve të Transportit Ajror Tregtar (CAT)

Një nga kërkesat e parashikuara në Urdhërin e Ministrit Nr. 262, date 28.06.2019 “Për kërkesat teknike dhe procedurat administrative në lidhje me ekuipazhin ajror të aviacionit civil”, Aneksi V (Pjesa CC), CC.TRA.220), është që çdo anëtar i ekuipazhit të kabinës duhet të kryejë një kurs fillestar trajnimi dhe t'i nënshtrohet një provimi për të demonstruar njohuritë dhe aftësitë. Trajnimi i kërkuar për këtë kurs fillestar mund të sigurohet nga një organizatë e miratuar për trajnimin e ekuipazhit të kabinës ose nga një operator i transportit ajror tregtar (CAT) i aprovuar specifikisht nga autoriteti kompetent për të ofruar një trajnim të tillë.

Aplikantët të cilët kanë përfunduar me sukses kursin e aprovuar të trajnimit fillestar të ekuipazhit të kabinës dhe e kanë kaluar me sukses provimin, iu lëshohet një “Dëshmi e Ekuipazhit të Kabinës” (CCA). Dëshmia lëshohet normalisht nga Autoriteti kompetent, i cili ka miratuar organizatën për të ofruar kete trajnim ose nga vetë organizata e aprovuar, në rast se Autoriteti kompetent ja ka aprovuar kete të drejte. Në Shqipëri, Autoriteti Kompetent është Autoriteti i Aviacionit Civil Shqiptar (AAC).

Një organizatë trajnimi për Ekuipazhin e Kabinës (CCTO) konsiderohet normalisht të jetë një Organizatë e vetme, me staf, pajisje dhe që operon në një ambient të përshtatshëm, që ofron trajnime teorike dhe instruksione praktike të kërkuara për kursin që ofrohet. Vendi (selia) kryesore e biznesit duhet të jetë në Shqipëri. Për më tepër, nëse trajnimi zhvillohet në vende të tjera, duhet të sigurohet një audit gjithëpërfshirës dhe proces i monitorimit të përputhshmërisë për të siguruar që këto vende të tjera plotësojnë të gjitha kërkesat.

Ky manual udhëzues ka synim që të realizojë dy qëllime:

1. Të ndihmojë organizatat dhe operatorët për të siguruar që një aplikim i bërë për miratimin për të ofruar kursin fillestar të trajnimit të ekuipazhit të kabinës duhet që të bindë AAC-në se kërkesat dhe standardet përkatëse janë përmbushur dhe do të vazhdojnë të përmbushen në vazhdimësi.

2. Të shpjegojë proceset administrative të cilat janë të aplikueshme në Shqipëri
Autoriteti i Aviacionit Civil Shqiptar kërkon që, organizata e cila aplikon për miratim duhet të jenë të pajisur me një kopje të Urdhërit të Ministrit Nr 262, date 28.06.2019 “Për kërkesat

Data e lëshimit: 15/10/2021	Rishikimi Nr: 00	Faqe: 3 nga 45
-----------------------------	------------------	----------------

	Manual Udhëzues për Miratimin e Organizatave të Trajnimit për Ekuipazhin e Kabinës (CCTO)	
	Zotëruesi	O3
	Dokumenti	O3-3 -MU/PT-004

teknike dhe procedurat administrative në lidhje me ekuipazhin ajror të aviacionit civil” duke përfshirë mjetet e pranueshme të përputhshmërisë (AMC) dhe Materialet Udhëzuese (GM) të zbatueshme në Shqipëri të cilat i gjeni në <https://www.aac.gov.al> ose <https://www.easa.europa.eu/document-library/general-publications/easy-access-rules-aircrew-regulation-eu-no-11782011>. Gjithashtu kërkohet që edhe përfaqësuesit e Organizatës të jenë të familjarizuar me përmbajtjen e tyre.

Një CCTO mund të bëjë marrëveshje trajnimi me organizata trajnimi ose ofrues të tjerë, por duhet të sigurojë që këto organizata të tjera të jenë në përputhje me kërkesat e duhura. Kur trajnimi ofrohet në disa vende të ndryshme, të gjitha këto vende mund t'i nënshtrohen inspektimit nga ana e AAC-së. Kreu i trajnimit i CCTO-së (HOT) është përgjegjës për standardet e trajnimit dhe pajtueshmërinë me kërkesat e zbatueshme. Kjo vlen gjithashtu edhe në rastin kur mund të jetë miratuar ose mund të përdoret për të ofruar disa pjesë të trajnimit një organizatë e nënkontraktuar.

Një kurs trajnimi fillestar i ekuipazhit të kabinës mund të sigurohet vetëm nga CCTO-ja e miratuar nga AAC. Kursi i trajnimit nuk mund të sigurohet nga ndonjë palë e tretë që vepron jashtë fushëveprimit të miratimit. Çdo ndryshim i propozuar për miratimin (përfshirë çdo ndryshim në strukturën organizative) duhet të njoftohet dhe miratohet / pranohet nga AAC.

SHENIM 1: Aplikantët për CCTO duhet të kuptojnë se miratimi i CCTO-së i lëshuar nga Autoriteti i Aviacionit Civil është i kufizuar në ofrimin e kursit të trajnimit fillestar të ekuipazhit të kabinës dhe provimit përkatës, me qëllim lëshimin e dëshmisë së Ekuipazhit të kabinës (CCA). Nuk ka pjesë shtesë të trajnimit të përfshira në këtë aprovim.

SHËNIM 2: Kërkesa plotësuese e trajnimit dhe kualifikimit të ekuipazhit, siç janë trajnimi për tipet specifike të avionit dhe ai i konvertimit, siç përcaktohet në Urdhrin e Ministrit Nr. 59, datë 30.01.2020, “Për kërkesat teknike dhe procedurat administrative të Operimeve Ajrore”, pjesa (OPS), i drejtohen operatorëve të Transportit Ajror Tregtar dhe nuk përfshihen në fushën e aprovimit të CCTO-së. Një CCTO mund të sigurojë vetëm trajnim specifik për tipin e avionëve dhe trajnimin e konvertimit nëse kontraktohet për ta bërë këtë nga një operator/mbajtës i AOC, i cili do të mbetet përgjegjës për trajnimin dhe kompetencën e ekuipazhit të tij të kabinës.

SHËNIM 3: CCTO-të nuk mund të përdorin logon e AAC-së ose markën e organizatës për të reklamuar ose publikuar miratimin e tyre nga AAC-ja për të kryer kursin e trajnimit fillestar të Pjesës CC. CCTO-të të cilët angazhohen në aktivitete, përveç ofrimit të kursit fillestar të trajnimit të Pjesës CC, nuk mund të përdorin miratimin e AAC-së, logon ose markën e organizatës për çdo qëllim reklamimi ose promovimi që lidhen me këto aktivitete shtesë.

Data e lëshimit: 15/10/2021	Rishikimi Nr: 00	Faqe: 4 nga 45
-----------------------------	------------------	----------------

	Manual Udhëzues për Miratimin e Organizatave të Trajnimit për Ekuipazhin e Kabinës (CCTO)	
	Zotëruesi	O3
	Dokumenti	O3-3 -MU/PT-004

Qëllimi i Manualit Udhëzues

Qëllimi i këtij manuali është të përshkruajë kërkesat, udhëzimet dhe procedurat e AAC-së për miratimin fillestar dhe mirëmbajtjen e vazhdueshme të këtij miratimi për Organizatat e Trajnimit të Ekuipazhit të Kabinës (CCTO)

Ky manual është lëshuar për të ofruar udhëzime për organizatat trajnuese dhe operatorët e transportit ajror tregtar të cilët kërkojnë miratimin nga AAC-ja, për të krijuar një organizatë të trajnimit të ekuipazhit të kabinës (CCTO) me qëllim të kryerjes së kursit të trajnimit fillestar dhe provimit shoqërues të përshkruar në Urdhërin e Ministrit Nr. 262, date 28.06.2019 "Për kërkesat teknike dhe procedurat administrative në lidhje me ekuipazhin ajror të aviacionit civil" Aneksi V, Pjesa CC e cila transpozon Rregulloren (EU) Nr. 1178 / 2011, e ndryshuar.

Data e lëshimit: 15/10/2021	Rishikimi Nr: 00	Faqe: 5 nga 45
-----------------------------	------------------	----------------

	Manual Udhëzues për Miratimin e Organizatave të Trajnimit për Ekuipazhin e Kabinës (CCTO)	
	Zotëruesi	O3
	Dokumenti	O3-3 -MU/PT-004

LISTA E FAQEVE EKZISTUESE

Titulli	Faqe	Nr. Rishikimit	Data
Parathënie	3 -5	00	15.10.2021
Lista e faqeve efektive	6	0	15.10.2021
Tabela e miratimit	7	00	15.10.2021
Lista e shpërndarjes / Regjistër i rishikimeve	8	00	15.10.2021
Shkurtesa dhe përkufizime	9-10	00	15.10.2021
Tabela e përmbajtjes	11	00	15.10.2021
Kapitulli I. Procesi I aplikimit-Marrja e Miratimit	12-15	00	15.10.2021
Kapitulli II. Aprovimi i CCTO	16-17	00	15.10.2021
Kapitulli III. Kërkesat për Personelin	18-21	00	15.10.2021
Kapitulli IV. Standartet e Trajnimit	22-23	00	15.10.2021
Kapitulli V. Manuali I Trajnimit dhe Manuali I Operimit	24-25	00	15.10.2021
Kapitulli VI. Rekordet	26-27	00	15.10.2021
Kapitulli VII. Manuali i Trajnimit dhe Programi i Trajnimit	28-35	00	15.10.2021
Kapitulli VIII. Procesi i Provimit	36-38	00	15.10.2021
Formulari i aplikimit	39-45	00	15.10.2021

Data e lëshimit: 15/10/2021	Rishikimi Nr: 00	Faqe: 6 nga 45
-----------------------------	------------------	----------------

	Manual Udhëzues për Miratimin e Organizatave të Trajnimit për Ekuipazhin e Kabinës (CCTO)	
	Zotëruesi	O3
	Dokumenti	O3-3 -MU/PT-004

LISTA E SHPËRNDARJES

Përdoruesi	Media/Mediumi	Sasia
Arkivi	Në Letër	2
	Elektronike	1
Intranet	Elektronike	1

REGJISTËR I RISHIKIMEVE

Nr:	Datë:	Rishikuar nga:	Miratuar nga:
1			
2			
3			
4, 1/10/2021			

	Manual Udhëzues për Miratimin e Organizatave të Trajnimit për Ekuipazhin e Kabinës (CCTO)	
	Zotëruesi	O3
	Dokumenti	O3-3 -MU/PT-004

PËRKUFIZIME

Për qëllimin e këtij manuali, termat e mëposhtëm nënkuptojnë:

"Aeroplan" do të thotë një avion me motor, me krahë te fiksuar, më i rënde se ajri, i cili mbështetet në fluturim nga reagimi dinamik i ajrit përkundrejt krahëve te tij.

"Anëtar i ekuipazhit te kabinës" nënkupton një anëtar të ekuipazhit të kualifikuar siç duhet, përveç një anëtari te ekuipazhit të fluturimit ose anëtar i ekuipazhit teknik, i cili është caktuar nga një operator për të kryer detyrat që lidhen me sigurinë e udhëtarëve dhe të fluturimit gjatë operimeve;

"Autoriteti i Aviacionit Civil Shqiptar (AAC)" është autoriteti kompetent i caktuar nga Republika e Shqipërisë.

EASA është Agjencia Evropiane e Sigurisë Ajrore

"Ekuipazh ajror" do të thotë anëtar i ekuipazhit të fluturimit dhe i ekuipazhit të kabinës;

"Mjetet e pranueshme të përputhshmërisë (AMC)" nënkuptojnë standardet jo detyruese të miratuara nga Agjencia për të ilustruar mjetet për të qenë në përputhje me Rregulloren (KE) nr. 1139/2018, transpozuar në shqipëri me Vendim të Këshillit të Ministrave Nr. 1095/2020 dhe rregulloret zbatuese të saj të cilat pranohen nga AAC

"Tip i avionit" nënkupton llojin e avionit që kërkon një kategorizim të tipit, siç përcaktohet në të dhënat operative të përshtatshmërisë të përcaktuara në përputhje me Pjesën-21, dhe të cilat përfshijnë të gjitha avionët e një projekti bazë të njëjtë, duke përfshirë të gjitha ndryshimet në to, përveç atyre që rezultojnë me një ndryshim në trajtimin apo karakteristikat e fluturimit.

"Transport ajror tregtar (CAT)" do të thotë transporti i udhëtarëve, mallrave ose postës kundrejt shpërblimit ose me qira.

Data e lëshimit: 15/10/2021	Rishikimi Nr: 00	Faqe: 9 nga 45
-----------------------------	------------------	----------------

	Manual Udhëzues për Miratimin e Organizatave të Trajnimit për Ekuipazhin e Kabinës (CCTO)	
	Zotëruesi	O3
	Dokumenti	O3-3 -MU/PT-004

SHKURTIME

Në këtë manual do të përdoren shkurtime të mëposhtëme, të cilat do të nënkuptojnë:

AAC	Autoriteti i Aviacionit Civil i Shqipërisë
RSH	Republika e Shqipërisë
MIE	Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë
DE	Drejtor Ekzekutiv
DMSOOA	Drejtoria e Mbikëqyrjes së Sigurisë në Operim të Operatorëve Ajrorë
CCM	Anëtar i Ekuipazhit të Kabinës
CCTO	Organizatë e Trajnimit për Ekuipazhin e Kabinës
HT	Drejtuesi i Trajnimeve

	Manual Udhëzues për Miratimin e Organizatave të Trajnimit për Ekuipazhin e Kabinës (CCTO)	
	Zotëruesi	O3
	Dokumenti	O3-3 -MU/PT-004

Tabela e Përmbajtjes

Hyrje.....	2
Parathënia	3-5
Lista e Faqeve Efektive	6
Lista e Shpërndarjes*	8
Tabela e rishikimeve	8
Termet dhe Definicionet / Shkurtime*/ Shpjegimi i Simboleve.....	8-9
Tabela e përmbajtjes	9-10
Kapitulli I- PROCESI I APLIKIMIT - MARRJA E MIRATIMIT	11-15
Kapitulli II- APROVIMI I CCTO	16-17
Kapitulli III- KËRKESAT PËR PERSONELIN	18-21
Kapitulli IV- STANDARDET E TRAJNIMIT	22-23
Kapitulli V-MANUALI I TRAJNIMIT DHE MANUALI I OPERIMEVE	24-25
Kapitulli VI-REKORDET	26-27
Kapitulli VII-MANUALI I TRAJNIMIT PROGRAMI I TRAJNIMIT.....	28-35
Kapitulli VIII-PROCESI I PROVIMIT.....	36-38
FORMULARI I APLIKIMIT	39-45

Data e lëshimit: 15/10/2021	Rishikimi Nr: 00	Faqe: 11 nga 45
-----------------------------	------------------	-----------------

	Manual Udhëzues për Miratimin e Organizatave të Trajnimit për Ekuipazhin e Kabinës (CCTO)	
	Zotëruesi	O3
	Dokumenti	O3-3 -MU/PT-004

Kapitulli I

PROCESI I APLIKIMIT - MARRJA E MIRATIMIT

Data e lëshimit: 15/10/2021	Rishikimi Nr: 00	Faqe: 12 nga 45
-----------------------------	------------------	-----------------

 AUTODIREKTIVAT AVIATIONISTE CERO	Manual Udhëzues për Miratimin e Organizatave të Trajnimit për Ekuipazhin e Kabinës (CCTO)	
	Zotëruesi	O3
	Dokumenti	O3-3 -MU/PT-004

Nevojiten burime dhe përpjekje të konsiderueshme për të përgatitur një aplikim fillestar për miratim për të kryer trajnime, veçanërisht në lidhje me zhvillimin dhe përpilimin e dokumentacionit të kërkuar.

Gjithashtu, shqyrtimi i një materiali të tillë kërkon përpjekje të stafit brenda departamenteve përkatëse të AAC-së dhe duhet të zërë vendin e saj përveç punëve dhe angazhimeve të tjera. Prandaj organizatat duhet të bëjnë supozime reale që në fillim se sa kohë do të duhet për të marrë miratimin dhe organizatat Aplikuese duhet të informojnë AAC-në për synimet e tyre që në fazën e hershme të planifikimit.

CCTO-të që synojnë të aplikojnë për miratim, duhet të parashikojnë fillimisht një takim me përfaqësues të Sektorit të Licensimit dhe Mbikëqyrjes së Personelit Ajror (FCL), për të diskutuar hollësitë e procesit të miratimit.

AAC do të miratojë vetëm kurse të përgatitura dhe të dorëzuara në gjuhën shqipe dhe angleze. Të gjithë materialet dhe dokumentet duhet të jenë në gjuhën shqipe dhe angleze. CCTO-të duhet të sigurojnë që pjesëmarrësit, për të cilët gjuha angleze është gjuhë e dytë, të kenë një nivel të krenaqshëm të gjuhës angleze të folur dhe të shkruar përpara se t'i pranojnë ato në kurs.

Një aplikant CCTO që kërkon miratimin, për të siguruar Trajnimin Fillestar për ekuipazhin e kabinës sipas Pjesës CC, duhet të aplikojë në AAC, duke përdorur formularin përkatës të aplikimit për CCTO të disponueshme në Shtojcën e këtij dokumenti, (shih formën e aplikimit)

Aplikimi duhet të përfshijë minimalisht dokumentacionin e mëposhtëm:

1. Një plan biznesi të hollësishëm, duke përfshirë evidencën e audituesit mbi qëndrueshmërinë financiare dhe një vlerësim të aktivitetit të trajnimit të parashikuar për një periudhë 24 mujore, pas aprovimit.
2. Strukturë e detajuar e menaxhimit të propozuar dhe CV-të e mbajtësit të posteve.
3. Manuali i Operimeve të CCTO-së që përmban: (Shih gjithashtu Kapitullin V të këtij dokumenti)
 - Strukturën organizative dhe përgjegjësitë e personelit kryesor, menaxherial.

Data e lëshimit: 15/10/2021	Rishikimi Nr: 00	Faqe: 13 nga 45
-----------------------------	------------------	-----------------

	Manual Udhëzues për Miratimin e Organizatave të Trajnimit për Ekuipazhin e Kabinës (CCTO)	
	Zotëruesi	O3
	Dokumenti	O3-3 -MU/PT-004

- Kriteret e pranueshmërisë për aplikantët pjesëmarrës që duhet të pranohen në kursin e trajnimit
 - Të gjitha informacionet që u jepen të trajnuarve gjatë kursit.
 - Procesi i amendimit të manualit.
4. Manuali i Trajnimit të CCTO-së që përmban: (shih gjithashtu Kapitullin V të këtij dokumenti)
- a. Kriteret e trajnimit dhe kualifikimit për personelin e CCTO-së.
 - b. Përmbajtja e kursit dhe metodologjia / procedurat për instruktorët dhe personat që trajnohen.
 - c. Procedurat për kryerjen e provimeve dhe mbajtjen e rekordeve.
 - d. Procesi i amendimit të manualit.
5. Manuali i Monitorimit të Pajtueshmërisë që përmban:
- Procedurat e monitorimit / mbikëqyrjes së pajtueshmërisë për aktivitetet e CCTO-së.
6. Manuali i Menaxhimit të Sigurisë që përmban:
- Një përshkrim të filozofive dhe parimeve të përgjithshme të organizatës në lidhje me sigurinë, referuar si politika e sigurisë dhe
 - Identifikimin e rreziqeve të sigurisë që vijnë nga aktivitetet e organizatës, vlerësimi i tyre dhe menaxhimi i rreziqeve që lidhen me to, përfshirë marrjen e masave për zbutjen e rrezikut dhe verifikimin e efektivitetit të tyre;
7. Lista e faciliteteve të jashtme që do të përdoren në kurs - (për t'u përfshirë kopjet e marrëveshjeve të qirasë, kontratat e qirasë, etj., Aty ku është e aplikueshme).
- Pishinat
 - Pajisjet simuluese të kabinës për trajnim
 - Simulatorët e trajnimit të zjarrit, etj.
8. Përshkrimi i akomodimit dhe faciliteteve - (për t'u përfshirë, kopjet e marrëveshjeve të qirasë, kontratat e qirasë, etj., aty ku është e aplikueshme):

Data e lëshimit: 15/10/2021	Rishikimi Nr: 00	Faqe: 14 nga 45
-----------------------------	------------------	-----------------

	Manual Udhëzues për Miratimin e Organizatave të Trajnimit për Ekuipazhin e Kabinës (CCTO)	
	Zotëruesi	O3
	Dokumenti	O3-3 -MU/PT-004

- a. Klasat
- b. Ambjentet e Instruktorëve dhe personave që trajnohen
- c. Ambientet e Administratës
- d. Numri i personelit dhe pjesëmarrësve në trajnim që mund të akomodohen
- e. Deklarata se objekti është i ndriçuar në mënyrë adekuate, i ventiluar dhe i lirë nga zhurmat dhe shqetësimet e jashtme

9. Lista e instruktorëve dhe ekzaminuesve, kualifikimet dhe vlefshmëria e tyre.

10. Evidencë për disponueshmërinë e vazhdueshme të pajisjeve, objekteve dhe instruktorëve.

11. (Samples) Shembuj të dokumentimit të kursit të trajnimit:

- Dokumentimi i Dëshmisë, duke përfshirë përgjegjësinë për mbajtjen e rekordeve
- Rekordet e trajnimit të CCTO-së
- Një shembull (Sample) e certifikatës për kalimin me sukses "Kryerja e kursit fillestar të Trajnimit dhe provimit për ekuipazh të kabinës"

12. "Kursi dhe Provimi"

13. Të paktën dy shembuj (Samples) të shkresës me pyetje të provimeve për provimin përfundimtar dhe për çdo modul trajnimi, sipas rastit

SHËNIM 4: CCTO Aplikuuese nuk do të dublojë paraqitjen e informacionit në lidhje me pikat e mësipërme nëse informacioni është i përfshirë ndërkohë në një dokument tjetër të dorëzuar, p.sh. Manuali i Trajnimit

SHËNIM 5: Si pjesë e miratimit fillestar dhe vazhdueshmërisë së CCTO-së, të gjitha pikat e mësipërme mund të nënshtrohen auditimit të AAC-së dhe inspektimeve në vend (duke përfshirë çdo aktivitet të nënkontraktuar).

Data e lëshimit: 15/10/2021	Rishikimi Nr: 00	Faqe: 15 nga 45
-----------------------------	------------------	-----------------

	Manual Udhëzues për Miratimin e Organizatave të Trajnimit për Ekuipazhin e Kabinës (CCTO)	
	Zotëruesi	O3
	Dokumenti	O3-3 -MU/PT-004

Kapitulli II

APROVIMI I CCTO

Data e lëshimit: 15/10/2021	Rishikimi Nr: 00	Faqe: 16 nga 45
-----------------------------	------------------	-----------------

	Manual Udhëzues për Miratimin e Organizatave të Trajnimit për Ekuipazhin e Kabinës (CCTO)	
	Zotëruesi	O3
	Dokumenti	O3-3 -MU/PT-004

Në varësi të auditimeve dhe inspektimeve të kënaqshme, do të lëshohet miratimi i CCTO-së nën drejtimin e Drejtuesit të Trajnimit (HT). Miratimi do të qëndrojë në fuqi, në varësi të inspektimit dhe auditimit të vazhdueshëm si dhe tarifës të përcaktuar të vazhdueshmërisë së miratimit vjetor.

AAC mund të ri-inspektojë CCTO-në në çdo kohë gjatë periudhës së miratimit. Raportet do t'i jepen CCTO-së pas vizitave të inspektimit nga AAC.

Vazhdueshmëria e një aprovimi nuk është automatike dhe varet nga aftësia e organizatës për të qëndruar në përputhje me kërkesat.

Një miratim i lëshuar nga AAC mund të kufizohet, revokohet ose pezullohet nëse kërkesat nuk plotësohen pjesërisht ose tërësisht ose nëse standardet për të cilat është dhënë miratimi nuk mbahen.

Nëse dështohet në përmbushjen e kërkesave ose standardeve, organizata do të njoftohet zyrtarisht për mospërputhshmërinë (të) e tyre. Do të identifikohen veprimet përmirësuese, përfshirë analizat e shkakut thelbësor, korrigjimet dhe hapat e veprimeve korrigjuese dhe marrëveshjet për afatet specifike.

Nëse CCTO nuk i përmbush standardet në kohën e përcaktuar; mund të merret parasysht kufizimi, revokimi ose pezullimi i miratimit.

Nëse një aprovim është revokuar dhe CCTO dëshiron të riaplikojë për rinovimin e këtij miratimi, atëherë duhet të ndiqet procesi fillestar i aplikimit dhe do të zbatohen tarifat përkatëse (sipas aplikimit).

Data e lëshimit: 15/10/2021	Rishikimi Nr: 00	Faqe: 17 nga 45
-----------------------------	------------------	-----------------

	Manual Udhëzues për Miratimin e Organizatave të Trajnimit për Ekuipazhin e Kabinës (CCTO)	
	Zotëruesi	O3
	Dokumenti	O3-3 -MU/PT-004

Kapitulli III

KËRKESAT PËR PERSONELIN

Data e lëshimit: 15/10/2021	Rishikimi Nr: 00	Faqe: 18 nga 45
-----------------------------	------------------	-----------------

	Manual Udhëzues për Miratimin e Organizatave të Trajnimit për Ekuipazhin e Kabinës (CCTO)	
	Zotëruesi	O3
	Dokumenti	O3-3 -MU/PT-004

Një numër i mjaftueshëm personeli i kualifikuar dhe kompetent, duhet të punësohet, dhe struktura drejtuese duhet të sigurojë mbikëqyrjen e të gjithë kategorive të personelit nga persona që kanë përvojën dhe cilësitë e nevojshme për të siguruar ruajtjen e standardeve të larta. AAC do t'i kushtojë vëmendje të veçantë kualifikimeve dhe kompetencave të të gjithë stafit të trajnimit në fushën e tyre të kualifikimit dhe në teknikat e trajnimit.

(1) Menaxheri Përgjegjës:

Nga organizata aplikuese duhet të emërohet një Menaxher Përgjegjës i cili duhet të jetë i pranueshëm për Autoritetin. Ky person duhet të ketë përvojë në aviacion dhe aftësi të shëndosha menaxheriale. Përvoja e mëparshme në menaxhim është thelbësore. Menaxheri përgjegjës ka autoritetin dhe përgjegjësinë për të siguruar që të gjitha aktivitetet mund të financohen dhe të kryhen në përputhje me rregulloret në fuqi. Menaxheri Përgjegjës duhet të jetë përgjegjës për krijimin dhe mirëmbajtjen e një sistemi efektiv të menaxhimit të CCTO-së. Çdo ndryshim i propozuar për Menaxherin e Përgjegjës të emëruar duhet t'i njoftohet Autoritetit përpara emërimit të tij në detyrë.

SHËNIM 6: I aplikueshëm për operatorët CAT:

Menaxheri përgjegjës për CCTO mund të jetë i njëjti Menaxher Përgjegjës, i emëruar në sistemin e menaxhimit të operatorit.

Drejtuesi i Trajnimit (HT)

Si Drejtues i Trajnimit (HT), duhet të propozohet një person i pranueshëm për Autoritetin. Ky person ka përgjegjësinë kryesore për të siguruar që trajnimi është në përputhje me kërkesat. HT duhet të ketë aftësi të shëndosha menaxheriale dhe përvojë të menaxhimit brenda aviacionit. HT duhet të trajnohet në aftësitë mësimore dhe të ketë përvojë të gjerë trajnimi si instruktor në kuadër të Operimeve të Transportit Ajror Tregtar (CAT).

SHËNIM 7: I zbatueshëm për operatorët CCTO jo-CAT:

Përveç kriterëve të përshkruara për HT më lart, HT-ja e emëruar duhet të ketë përvojë të gjerë si instruktor i ekuipazhit të kabinës në operimet CAT, duhet të jetë një mbajtës i tanishëm i CCA dhe ekspert i kursit trajnues . Për të siguruar vazhdimësinë e standardeve të kërkuara të trajnimit dhe një pajtueshmëri të vazhdueshme me kërkesat përkatëse, duhet të emërohet edhe një zëvendës i HT. Ky zëvendës mund të jetë Shefi i instruktorëve i CCTO-së, i cili duhet të jetë mbajtës i një CCA të vlefshme dhe ekspert i kursit të trajnimit të CCTO-së. Si minimum, në çdo kohë, ose HT ose zëvendësi i tij duhet të jetë një mbajtës i një CCA të vlefshme.

Data e lëshimit: 15/10/2021	Rishikimi Nr: 00	Faqe: 19 nga 45
-----------------------------	------------------	-----------------

	Manual Udhëzues për Miratimin e Organizatave të Trajnimit për Ekuipazhin e Kabinës (CCTO)	
	Zotëruesi	O3
	Dokumenti	O3-3 -MU/PT-004

SHENIM 8: I zbatueshëm për CCTO - operimet CAT: Në lidhje me kriteret e përshkruara në paragrafin (2) më lart, HT - i i emëruar për CCTO mund të jetë i njëjti HT, i emëruar në sistemin e menaxhimit të operatorit. Në këtë rast, HT dhe zëvendësi i tij / saj ka gjasa të jenë pilotë operacionalë, të cilët nuk mbajnë CCA të vlefshme. Prandaj, duhet të caktohet një shef i Instruktorëve të CCTO-së, i cili është një mbajtës i një CCA të vlefshme dhe ekspert i kursit të trajnimit të CCTO.

(2) Shefi i Instruktorëve i CCTO-së (CI)

Ky person duhet të jetë një mbajtës i një CCA të vlefshme dhe ekspert i kursit të trajnimit CCTO. Shefi i Instruktorëve të CCTO duhet të ketë një linjë të drejtpërdrejtë raportimi me Drejtuesin e emëruar të Trajnimit (HT) të CCTO-së.

SHËNIM 9: CCTO duhet të përshkruajë në Manualin e Operimeve / Trajnimit kriteret shtesë të kualifikimit që ai i konsideron të nevojshme për personat që mbajnë pozicionin e Drejtuesit të Trajnimit, Zëvendës Drejtuesit të Trajnimit dhe Kryeinstruktorit në mënyrë që të sigurojnë që këta persona të kenë aftësitë, kompetencat e kërkuara dhe nivelet e përvojës për ekzekutimin e detyrave të tyre të caktuara. Procedura të tilla duhet të jenë të pranueshme për Autoritetin.

(3) Menaxheri i Monitorimit të Pajtueshmërisë duhet të ketë aftësi dhe të menaxhimit në Monitorimin e Pajtueshmërisë dhe përvojën në aviacionin. Përvoja në një mjedis trajnimi dhe trajnimi në aftësitë mësimore janë të dëshirueshme.

SHËNIM 10: Operatorët CAT: Menaxheri i Monitorimit të Pajtueshmërisë mund të jetë i njëjti Menaxher i Monitorimit të Pajtueshmërisë, i emëruar në sistemin e menaxhimit të operatorit.

(4) Menaxheri i Sigurisë duhet të ketë një formim dhe aftësi menaxhimi në Sistemet e Menaxhimit të Sigurisë dhe përvojë në aviacion. Përvoja në një mjedis trajnimi dhe trajnimi në aftësitë mësimdhënëse janë të dëshirueshme.

SHËNIM 11: Operatorët CAT: Menaxheri i Sigurisë mund të jetë i njëjti Menaxher i Sigurisë, i emëruar në sistemin e menaxhimit të operatorit.

(5) Instruktorët

Instruktorët duhet të kenë eksperiencë aktuale ose të mëparshme si anëtarë të ekuipazhit të kabinës brenda operimeve CAT, preferueshëm në nivelin e anëtarit të lartë të ekuipazhit të kabinës (SCCM). Ata duhet të jenë të trajnuar në aftësitë mësimdhënëse dhe të kenë përvojë të gjerë trajnimi si instruktor i ekuipazhit të kabinës në fushën e kompetencës së tyre në një mjedis trajnimi të ekuipazhit të kabinës me një operator CAT.

Data e lëshimit: 15/10/2021	Rishikimi Nr: 00	Faqe: 20 nga 45
-----------------------------	------------------	-----------------

	Manual Udhëzues për Miratimin e Organizatave të Trajnimit për Ekuipazhin e Kabinës (CCTO)	
	Zotëruesi	O3
	Dokumenti	O3-3 -MU/PT-004

Për të siguruar vazhdimësinë e njohurive dhe vlefshmërinë me materialet e kërkuara të trajnimit, instruktorët që janë të përfshirë në instruktimin e aspekteve të përgjithshme të kursit të trajnimit të ekuipazhit të kabinës duhet të jenë mbajtës të një CCA të vlefshme.

Për emërimin e instruktorëve, CCTO duhet të marrë në konsideratë, përpara përzgjedhjes së instruktorëve aplikantë, provojën, aftësitë e tyre duke dhënë një leksion provë bazuar në materialin që ata kanë zhvilluar për lëndën që ata do të japin mësim.

Shënimi 12: Kërkesat e mësipërme nuk përjashtojnë që një ekspert i lëndës të autorizohet të japë mësim në çështjet që kanë të bëjnë me fushën e tyre të ekspertizës. Kritere kualifikimi të vecanta/ shtesë të mund të kërkohen për ekspertët e lëndës, për sa i përket subjektit të veçantë që duhet mbuluar.

CCTO duhet të parashikojnë vazhdimësinë në rastet kur personi përgjegjës i emëruar për Trajnimin (HT) ose shefi i Instruktorëve (CI) bëhet i padisponueshëm.

Nëse Drejtuesi i Trajnimit pushon së qeni i punësuar nga CCTO, duhet të aplikohet një kërkesë për ndryshimin e aprovimit të CCTO. AAC duhet të informohet për largimin ose largimin e planifikuar të Drejtuesit të Trajnimit. Në këto rrethana, CCTO duhet të bëjë rregullimet e duhura për vazhdimësinë dhe, caktimi i një drejtuesi të ri të Trajnimit duhet të bëhet sa më shpejt që të jetë e mundur. Pranueshmëria nga AAC e një aplikuesi të paramenduar duhet të konfirmohet para se të bëhet emërimi.

Duhet të punësohen instruktorë mjaftueshëm për të siguruar vazhdueshmërinë e duhur të trajnimit për të gjithë të trajnuarit që do të ndjekin kursin. Të gjithë instruktorët duhet të kenë përvojë dhe kualifikim të përshtatshëm për elementet e trajnimit që duhet të mbulojnë. Ata duhet të mbajnë kualifikimet e tyre të vlefshme në përputhje me kërkesat e manualit të trajnimit të miratuar të CCTO.

	Manual Udhëzues për Miratimin e Organizatave të Trajnimit për Ekuipazhin e Kabinës (CCTO)	
	Zotëruesi	O3
	Dokumenti	O3-3 -MU/PT-004

Kapitulli IV

STANDARDET E TRAJNIMIT

Data e lëshimit: 15/10/2021	Rishikimi Nr: 00	Faqe: 22 nga 45
-----------------------------	------------------	-----------------

	Manual Udhëzues për Miratimin e Organizatave të Trajnimit për Ekuipazhin e Kabinës (CCTO)	
	Zotëruesi	O3
	Dokumenti	O3-3 -MU/PT-004

Autoriteti i Aviacionit Civil kërkon që të merren masat e duhura nga Drejtuesi i Trajnimit për standardizimin e instruktorëve dhe sigurimin e materialit udhëzues për instruktorin. Këto masa duhet të detajohen në Manualin e Trajnimit.

Duhet të merren masat për standardizimin dhe kontrollin periodik të instruktorëve. Këto trajnime dhe kontrole duhet të regjistrohen nga CCTO dhe do t'ë jenë subjekt i auditimit të brendshëm nga Sistemi i Monitorimit të Përputhshmërisë së organizatës.

 AEROPORTI I TIRANËS S.p.A.	Manual Udhëzues për Miratimin e Organizatave të Trajnimit për Ekuipazhin e Kabinës (CCTO)	
	Zotëruesi	O3
	Dokumenti	O3-3 -MU/PT-004

Kapitulli V

MANUALI I TRAJNIMIT DHE MANUALI I OPERIMIT

Data e lëshimit: 15/10/2021	Rishikimi Nr: 00	Faqe: 24 nga 45
-----------------------------	------------------	-----------------

	Manual Udhëzues për Miratimin e Organizatave të Trajnimit për Ekuipazhin e Kabinës (CCTO)	
	Zotëruesi	O3
	Dokumenti	O3-3 -MU/PT-004

CCTO duhet të përgatis dhe të mbajë një manual trajnimi dhe një manual operimesh që përmban informacione dhe udhëzime për të ndihmuar personelin që të kryejnë detyrat e tyre dhe për të ofruar udhëzime për studentët se si të përmbushin kërkesat e kursit.

CCTO duhet t'i vëri në dispozicion të stafit të saj dhe, kur është e përshtatshme, nxënësve informacionet përkatëse të përfshira në manualin e trajnimit, manualin e operimeve dhe dokumentacionin e aprovimit të CCTO.

Manuali i trajnimit duhet të përcaktojë standardet, objektivat dhe qëllimet e trajnimit për secilën fazë të trajnimit, që u kërkohet nxënësve për ti përfunduar dhe duhet të adresojnë të gjitha pikat e përfshira në Rregulloren e Ekuipazhit të Ajrit, Shtojca 1 e Aneksit V, të Pjesës CC.

Përmbajtja dhe ndarjet e programit të trajnimit duhet të specifikohen në manualin e trajnimit.

Programet e detajuara të trajnimit duhet të dokumentohen në manualin e trajnimit dhe shënimet e kursit të instruktorit duhet të lëshohen dhe kontrollohen nga drejtuesi i Trajnimit HT/shefi i instruktorëve.

Data e lëshimit: 15/10/2021	Rishikimi Nr: 00	Faqe: 25 nga 45
-----------------------------	------------------	-----------------

	Manual Udhëzues për Miratimin e Organizatave të Trajnimit për Ekuipazhin e Kabinës (CCTO)	
	Zotëruesi	O3
	Dokumenti	O3-3 -MU/PT-004

Kapitulli VI

REKORDET

Data e lëshimit: 15/10/2021	Rishikimi Nr: 00	Faqe: 26 nga 45
-----------------------------	------------------	-----------------

	Manual Udhëzues për Miratimin e Organizatave të Trajnimit për Ekuipazhin e Kabinës (CCTO)	
	Zotëruesi	O3
	Dokumenti	O3-3 -MU/PT-004

Formati i rekordeve të Trajnimit duhet të përcaktohet në Manualin e Trajnimit dhe duhet të përputhet me formatet e pranueshme për AAC-në.

Drejtuesi i trajnimit të CCTO-së ose zëvendësi i tij / saj duhet të vërtetojë se secili aplikant për dëshmi të ekuipazhit të kabinës (CCA) ka përfunduar me sukses të gjitha elementet e kursit të trajnimit fillestar të kërkuar dhe ka kaluar provimin shoqërues. Ky certifikim mund të marrë formën e një "Certifikatë të Përfundimit të Kursit Fillestar të Trajnimit sipas Pjesës CC.

Çdo dokumentacion i tillë, i cili kërkohet për të lëshuar një dëshmi, duhet të jetë në përputhje me kërkesat e Licencimit të Personelit Ajror të AAC dhe të jetë i pranueshëm për AAC-në.

Një person përgjegjës brenda CCTO duhet të emërohet për të marrë përgjegjësinë për procedurat e Dëshmisë/Attestation dhe për ndërlidhjen me Sektorin e Licencimit të Personelit Ajror të AAC, lidhur me lëshimin e CCA dhe të gjitha çështjet e CCA.

Dëshmitë duhet të lëshohen nga AAC ose nga një organizatë e miratuar për ta bërë këtë në emër të AAC, kandidatëve të suksesshëm, pas përfundimit me sukses të trajnimit të kërkuar dhe provimit përkatës dhe me kusht që të gjitha dokumentet të jenë plotësuar në mënyrë të kënaqshme dhe, nëse është e aplikueshme, kur pagesa e duhur është paguar paraprakisht në AAC.

CCTO mban të gjitha rekordet përkatëse për një minimum prej pesë vitesh.

Data e lëshimit: 15/10/2021	Rishikimi Nr: 00	Faqe: 27 nga 45
-----------------------------	------------------	-----------------

 AERODROMI I AVIACIONIS CIVIL	Manual Udhëzues për Miratimin e Organizatave të Trajnimit për Ekuipazhin e Kabinës (CCTO)	
	Zotëruesi	O3
	Dokumenti	O3-3 -MU/PT-004

Kapitulli VII

MANUALI I TRAJNIMIT DHE PROGRAMI I TRAJNIMIT

Data e lëshimit: 15/10/2021	Rishikimi Nr: 00	Faqe: 28 nga 45
-----------------------------	------------------	-----------------

	Manual Udhëzues për Miratimin e Organizatave të Trajnimit për Ekuipazhin e Kabinës (CCTO)	
	Zotëruesi	O3
	Dokumenti	O3-3 -MU/PT-004

Manuali i Trajnimit do të përcaktojë kërkesat e hyrjes në kurs. Para pranimit të aplikantëve në një kurs trajnimi, CCTO duhet të sigurojnë që aplikuesit të përmbushin kriteret e pranimit të paraqitura në Aneksin V Pjesa CC. CCTO, duhet gjithashtu të informojë aplikantët e kurseve të trajnimit se do t'u kërkohej që të përmbushin kërkesat mjekësore për ekuipazhin e kabinës të përcaktuar në Aneksin IV, Pjesa MED, me qëllim që të ushtrojnë privilegjet e dëshmisë së ekuipazhit të kabinës.

Manuali i Trajnimit do të përfshijë standardet dhe objektivat për secilin modul që të trajnuarit duhet të plotësojnë. Kohëzgjatja dhe vëllimi i trajnimit i përshtatshëm për kursin, duhet të përcaktohet për një student me kërkesat minimale të hyrjes, siç detajohet në Manualin e Trajnimit.

Përmbajtja e kursit të trajnimit duhet t'u mundësojë pjesëmarrësve të njihen me mjedisin e aviacionit dhe të fitojnë mjaftueshëm njohuri të përgjithshme dhe aftësi bazike të nevojshme për kryerjen dhe nxjerrjen e përgjegjësiave që lidhen me sigurinë e pasagjerëve dhe fluturimit gjatë operimeve normale, anormale dhe emergjencave. Përmbajtja e kursit duhet të bazohet në informacione dhe procedura të përgjithshme dhe të ofrojë një varg shembujsh të rëndësishme për operimet tipike brenda industrisë së aviacionit. Nuk duhet t'i referohet një tipi të vecantë avioni dhe nuk duhet t'i referohet ekskluzivisht kërkesave operacionale të një mbajtësi të AOC-së. Programi i kursit fillestar të trajnimit duhet të përfshijë të paktën elementet e specifikuar në Shtojcën 1 të Pjesës CC të Aneksit V të Rregullores për kërkesat teknike dhe procedurat administrative në lidhje me ekuipazhin ajror të aviacionit civil Nr. 262 dt 28.06.2019 që transponon (EU) Reg. 1178/2011, të ndryshuar.

Si rregull i përgjithshëm, i gjithë programi i Trajnimit Fillestar duhet të përbëhet minimalisht prej 70 orë mësimi ku kohëzgjatja e një dite trajnimi duhet të jetë deri në 8 orë duke përfshirë pushimet e drekës / rifreskimit. Në realitet, kjo shifër normalisht është tejkaluar. Shifra minimale prej 70 orësh supozon se trajnimi do të kryhet në baza të plota dhe gjatë një periudhe të vazhdueshme.

CCTO-të që dëshirojnë të propozojnë alternativa të tjera për ofrimin e programit të trajnimit duhet të konsultohen me AAC-në. Në të gjitha rrethanat, CCTO të duhet të sigurojnë që i gjithë programi i trajnimit fillestar të përfundojë brenda një afati prej 12 javësh.

